

Vendim nr. 122 datë 08.06.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Fiona Papajorgji,	Anëtare
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 08.06.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (D) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **DASHAMIR URUÇI**

OBJEKTI: **Konstatimi i cenimit të së drejtës për përdorimin e mjeteve juridike efektive dhe detyrimin e subjekteve të interesuara për ekzekutimin e vendimit nr. 852, datë 21.11.2012 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të së ndjerës Esmeralda Uruçi”.**

Shfuqizimi i vendimeve nr. regj. them. 51 (31134-00299-80), datë 02.02.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 183, datë 12.09.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2022-3668, datë 07.12.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rigjykim.

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e**

Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 852, datë 21.11.2012 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të së ndjerës Esmeralda Uruçi” (*VKM nr. 852/2012*), e cila është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 165, datë 24.12.2012. Kërkuesi, i cili rezulton se është bashkëshorti i së ndjerës, i është drejtuar rrugës gjyqësore me kërkesë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të VKM-së nr. 852/2012.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. regj. them. 51 (31134-00299-80), datë 02.02.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në ligj dhe në prova, me arsyetimin se VKM-ja nr. 852/2012 nuk përbënte titull ekzekutiv në kuptim të ndonjë ligji të posaçëm, sipas përcaktimit të shkronjës “e” të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*). Gjithashtu, ajo nuk parashikonte në mënyrë të shprehur, në ndonjë nga pikat e saj, se përbënte titull ekzekutiv dhe se, në mungesë të ekzekutimit vullnetar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave, të cilat ngarkohen për ta zbatuar, do të ishte shërbimi përmbarimor gjyqësor ai që do të bënte ekzekutimin e detyrueshëm të saj. Në këto kushte, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vlerësuar se nuk ka legjitimitet për të lëshuar urdhrin e ekzekutimit dhe e ka rrëzuar kërkesën e paraqitur nga kërkuesi. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë ai ka ushtruar ankim të veçantë..

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 183, datë 12.09.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Në arsyetimin e saj, Gjykata Administrative e Apelit, përveç qëndrimit të gjykatës së shkallës së parë, evidenton faktin se në pikën 3 të VKM-së nr. 852/2012 është parashikuar: “3. *Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave për shërbimin e ofruar.*”. Rrjedhimisht, ajo ka përcaktuar të drejta dhe detyrime të dyanshme si për institucionet shtetërore, ashtu edhe për subjektin që mbështetej me financim. Sipas Gjykatës Administrative të Apelit, fakti i mosveprimit të organeve të administratës shtetërore përbën shkak për ngritje padie kontencioze (me palë kundërshtarë),

me objekt detyrimin e tyre gjyqësisht për të vepruar, në rastin konkret për të zbatuar VKM-në nr. 852/2012. Pikërisht në këtë gjykim do të mund të verifikohet paraprakisht përmbushja ose jo nga kërkuesi, e detyrimit për dorëzimin e faturave lidhur me shërbimin e ofruar të së ndjerës dhe në varësi të këtij fakti, do të arrihej në përfundimin nëse mosveprimet e këtyre dy institucioneve ishin kushtëzuar ose jo nga veprimet e kërkuesit. Vendimi gjyqësor, në bazë të të cilit ai do të rezultonte gjyqfitues, duke vërtetuar paligjshmërinë e mosveprimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Financave, nëse do të merrte formë të prerë, do të shndërrohej në titull ekzekutiv, në kuptim të nenit 510, shkronja “a”, të KPC-së, duke i hapur rrugë procesit të ekzekutimit të detyrueshëm, nëse do të mungonte vullneti për ekzekutim vullnetar. Kundër këtij vendimi ka bërë rekurs kërkuesi.

4. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-3668, datë 07.12.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*). Sipas Kolegjit Administrativ, gjykatat më të ulëta i kanë interpretuar drejtë kërkesat e nenit 510, shkronja “e”, të KPC-së, si dhe kërkuesi në rekurs dhe gjatë gjykimit në gjykatat më të ulëta nuk ka parashtruar asnjë rrethanë nga ato që ligji i kërkon shprehimisht për ta quajtur një akt të caktuar titull ekzekutiv.

5. Në datën 07.04.2023 kërkuesi, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të kërkesës.

II

Pretendimet e kërkuesit

6. **Kërkuesi**, në kërkesën drejtuar Gjykatës, ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të:

6.1. *Mungesës së mjeteve efektive*, pasi në momentin që gjykatat kanë vlerësuar se nuk mund të lëshojnë një urdhër ekzekutimi, kërkuesi ka mbetur pa asnjë mjet ligjor efektiv për të kërkuar përmbushjen e detyrimit. Në këto kushte, kur legjislacioni nuk i njeh asnjë mënyrë dhe asnjë mjet, kërkuesit i është cenuar e drejta për të pasur mjete ligjore efektive dhe e drejta e aksesit.

6.2. *Së drejtës së aksesit*, pasi gjykatat kanë arsyetuar se do të duhet të ishim përpara një gjykimi me palë kundërshtare, ndërkohë që në rastin konkret, nuk mund të jemi përpara një gjykimi tillë, sepse vetë Këshilli i Ministrave ku në përbërje është edhe

Ministria e Shëndetësisë i ka ngarkuar kësaj të fundit detyrimin për t'i paguar kërkuarit një shumë të caktuar.

- 6.3. *Së drejtës për t'u dëgjuar dhe parimit të kontradiktoritetit*, pasi në kushtet kur seanca gjyqësore për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit sipas legjislacionit në fuqi është një gjykim me dyer të mbyllura, minimalisht nga ana e gjykatës së shkallës së parë duhet të kishte argumente të plota për mospranimin e kërkesës.. Kërkesat e depozituara nga kërkuari dhe faturat kanë qenë të pamundura për t'u ekzekutuar si në rrugë administrative, ashtu edhe në rrugë gjyqësore.
- 6.4. *Standardit të arsytimit*, pasi vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është tërësisht i paarsyetuar. Kolegji Administrativ nuk i ka kthyer përgjigje pretendimeve të kërkuarit të ngritura në rekurs, se përse nuk jemi përpara ndonjë prej rasteve të parashikuara nga neni 510 i KPC-së. Kjo është një çështje me rëndësi për zhvillimin e praktikës.
- 6.5. *Së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi çështja ndodhej në Gjykatën e Lartë që prej datës 30.12.2019 dhe vendimi është marrë në datën 07.12.2022, pra pas rreth 3 vjetësh. Sipas nenit 60 të ligjit nr. 49/2012, Kolegji Administrativ duhet ta kishte shqyrtuar këtë çështje brenda 90 ditëve.
- 6.6. *Së drejtës së pronës*, pasi duke iu referuar VKM-së nr. 852/2012, kërkuari duhet të kishte marrë shumën prej 6,000,000 lekësh që në kohën e miratimit të saj. Është pikërisht kjo VKM që si akt individual ia ka njohur kërkuarit këtë të drejtë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

8. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

9. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se, si rregull, individ mund t’i drejtohet asaj për kontrollin e kushtetutshmërisë së një vendimi gjyqësor, i cili ka vendosur në mënyrë përfundimtare mbi të drejtën kushtetuese që pretendohet të jetë cenuar (*shih vendimin nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegji konstaton se në vendimin e saj gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se VKM-ja nr. 852/2012 nuk përbën titull ekzekutiv në kuptim të ndonjë ligji të posaçëm, sipas përcaktimit të shkronjës “e” të nenit 510 të KPC-së (*shih faqen 4 të vendimit të gjykatës së shkallës së parë*). Ndërkohë, gjykata e apelit, krahas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë, ka çmuar se pretendimi i kërkuetit për mosveprimin e organeve shtetërore përbën shkak për ngritje padie kontencioze (me palë kundërshtare). Në këtë kuptim, Kolegji vëren se gjykata e apelit e ka orientuar kërkuetin që të ngrejë padi kundër organeve shtetërore të ngarkuara me zbatimin e VKM-së nr. 852/2012, me objekt detyrimin e tyre për zbatimin e kësaj të fundit. Më tej, sipas gjykatës së apelit, vendimi gjyqësor në bazë të të cilit kërkuesi do të rezultonte gjyqfitues, duke vërtetuar paligjshmërinë e mosveprimeve të organeve shtetërore, nëse do të merrte formë të prerë, do të shndërrohej në titull ekzekutiv, në kuptim të nenit 510, shkronja “a”, të KPC-së, duke i hapur rrugën procesit të ekzekutimit të detyrueshëm, nëse do të mungonte vullneti për ekzekutimin vullnetar (*shih faqen 6 të vendimit të gjykatës së apelit*). Ndërsa, sipas Kolegjit Administrativ, kërkuesi në rekurs dhe gjatë gjykimit në gjykatat më të ulëta nuk ka parashtruar asnjë rrethanë nga ato që ligji i kërkon shprehimisht për ta quajtur një akt të caktuar titull ekzekutiv (*shih paragrafin 11 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

11. Për sa më sipër, Kolegji konstaton se qëllimi i shterimit të mjeteve juridike efektive, para së gjithash, vlen për t’iu ofruar mundësinë e korrigjimit të shkeljes, së pari, gjykatave të zakonshme. Ai bazohet në premisën se këto gjykata e kanë mundësinë e korrigjimit të saj dhe

se kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare. Megjithatë, kjo nuk duhet të jetë vetëm një mundësi që i kërkohet individit të verifikohet formalisht, por duhet që, së pari, gjykatat e zakonshme të kenë kompetencën për të vendosur për një çështje të caktuar, të shtruar përpara tyre për zgjidhje, në kuptimin që çështjet që më pas i nënshtrohen gjykimit kushtetues të jenë vlerësuar dhe t'u jetë dhënë një përgjigje përfundimtare nga ato gjykata për bazueshmërinë e tyre.

12. Në këtë kuptim, duke qenë se kërkuesi i është drejtuar të tria shkallëve të gjykimit, edhe pse formalisht i ka shteruar mjetet juridike efektive në lidhje me procesin gjyqësor të vënë në lëvizje prej tij për ekzekutimin e shumës së akorduar me VKM-në nr. 852/2012, në kushtet kur është bërë me dije nga Gjykata Administrative e Apelit për ekzistencën e mjeteve të tjera ligjore në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij individuale, Kolegji vlerëson se ai nuk ka arritur t'i argumentojë ato përpara Gjykatës se përse paraqitja e ankimit kushtetues individual është mjeti i fundit në dispozicion të tij për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që pretendon se i janë cenuar, ose pse gjykatat administrative janë mjete joefektive për të vendosur detyrimin e organeve përgjegjëse për ekzekutimin e VKM-së nr. 852/2012. Në këtë kuptim, kërkuesi nuk ka arritur të provojë se e drejta e tij substanciale është cenuar nga procesi gjyqësor i kundërshtuar në këtë ankim kushtetues individual.

13. Në lidhje me procesin gjyqësor të kundërshtuar, kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, pasi çështja ndodhej në Gjykatën e Lartë që prej datës 30.12.2019 dhe vendimi është marrë në datën 07.12.2022, pra pothuaj pas rreth 3 vjetësh. Këtë pretendim kërkuesi e ka parashtruar drejtpërdrejt në ankimin kushtetues individual, pa shteruar paraprakisht mjetet juridike efektive në dispozicion të saj, sipas neneve 399/1 – 399/12 të KPC-së, pra pa iu drejtuar gjykatës kompetente me kërkesë për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procedurave. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se, si rregull, shqyrtimi i këtyre lloj çështjesh dhe vlerësimi përfundimtar për kohëzgjatjen e arsyeshme të gjykimit duhet të bëhet nga gjykatat e zakonshme, sipas kompetencës që parashikon KPC-ja, në përputhje me parimin e subsidiaritetit. Në analizë të kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, Gjykata ka pranuar se, në parim, mjetet e parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (*shih vendimet nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Për sa më lart, në rastin konkret, Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet ligjore efektive në dispozicion të tij në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm administrativ, përpara se t'i drejtohet kësaj Gjykate.

15. Si përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.